

**Vendim nr. 172 datë 13.07.2023**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare

Sonila Bejtja, Anëtare

Fiona Papajorgji, Anëtare

në datën 13.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (G) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** GENC TAFILAJ

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 221, datë 17.05.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2022-1617 (334), datë 15.12.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 17/2, 29/3, 42, 122/2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Shtetasi Genc Tafilaj (*kërkuesi*) është deklaruar fajtor dhe është dënuar me 20 vjet burgim me vendimin nr. 181, datë 13.07.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për kryerjen e veprave penale “Vrasja me dashje e punonjësit të policisë”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 79, shkronja “c” dhe 25 të Kodit Penal (KP), si dhe “Armëmbajtja pa leje”, të parashikuar nga neni 278/2 i KP-së. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 165, datë 02.11.2001 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

2. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 197, datë 21.03.2002, ka vendosur lënien në fuqi të vendimeve të mësipërme, lidhur me cilësimin ligjor të veprës dhe deklarimin fajtor të kërkuesit, ndërsa për sa i përket masës së dënimit, kjo gjykatë e ka dënuar kërkuesin përfundimisht me 25 vjet burgim.

3. Pasi ka vuajtur 21 vjet, 7 muaj e 4 ditë burgim pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Fushë-Krujë, në datën 19.09.2017 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, duke kërkuar lirimin me kusht për pjesën e mbetur të dënimit.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr. 69, datë 06.11.2017, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës së kërkuesit Genc Tafili. Lirimin me kusht të kërkuesit (dënuarit) Genc Tafili për dënimin e mbetur të pavaajtur prej 3 vjet, 3 muaj e 18 ditë burgim për një kohë provë prej 3 vjet, 3 muaj, e 18 ditë. Në zbatim të nenit 60 pika 9 e K. Penal, i dënuari Genc Tafili detyrohet që gjatë kësaj kohe të mos shoqërohet me persona të caktuar kryesisht me të dënuar apo bashkëpunëtorët e veprës penale. Urdhërohet i dënuari Genc Tafili të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të dënuarit Genc Tafili nëse nuk mbahet për ndonjë vepër tjetër penale. Urdhërohet Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë për ekzekutimin e këtij vendimi [...]”*. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, e cila ka kërkuar ndryshimin e tij dhe rrëzimin e kërkesës për lirimin me kusht të kërkuesit. Kundër ankimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, kërkuesi ka paraqitur apel kundërshtues.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 221, datë 17.05.2021, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 69, datë 06.11.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe rrëzimin e kërkesës së kërkuesit me objekt “Lirim me kusht”, duke arsyetuar se faza e ekzekutimit të vendimit penal është një fazë e shkëputur nga procesi penal, ndaj edhe në rastin konkret duhej të zbatohet ligji penal material që ishte në fuqi në kohën e ekzekutimit të dënimit. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1617 (334), datë 15.12.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke arsyetuar se në fazën e ekzekutimit të një vendimi penal gjen zbatim dispozita penale që ishte në fuqi në kohën e ekzekutimit të dënimit, pasi kjo fazë lidhet me elemente që kanë të bëjnë me sjelljen e të dënuarit pranë institucioneve të vuajtjes së dënimit, me uljen e dënimit, me lejet shpërblyese që kanë si qëllim final mundësinë e riintegritimit në shoqëri të të dënuarit.

7. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) në datën 24.04.2023 me ankim kushtetues individual, me objekt shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe atij përfundimtar të Gjykatës së Lartë, si të papajftueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

## II

### **Pretendimet e kërkuesit**

8. Kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

8.1. *Parimi i sigurisë juridike në aspekt të pritshmërive të ligjshme*, pasi kërkuesi është rikthyer në burg pas 4 vjetësh që gëzonte lirinë në bazë të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Neni 64 i KP-së është ndryshuar në vitin 2013, kur ai kishte kryer pjesën më të madhe të dënimit penal dhe kishte pritshmëri të ligjshme për përfitimin e lirisë me kusht. Në këto kushte, ndaj tij nuk duhej aplikuar kriteri ndalues sipas ndryshimeve të reja ligjore.

8.2. *Parimi i detyrimit të gjykatave kombëtare për të marrë në konsideratë KEDNJ-në dhe vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)*, sipas neneve 17, pika 2 dhe 122, pika 2, të Kushtetutës, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet të kishte pranuar rekursin dhe të vendoste prishjen e vendimit nr. 221, datë 17.05.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke mbajtur në konsideratë qëndrimin e GJEDNJ-së se për të dënuarin aplikohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale. Në rastin konkret, në kohën e kryerjes së veprës penale nga kërkuesi, dispozita ndaluese që përcaktonte kufizimin e së drejtës për lirim me kusht nuk ka ekzistuar, për rrjedhojë nuk ka asnjë pengesë ligjore për lirimin e tij para kohe me kusht.

8.3. *Parimi i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues*, i garantuar nga neni 29, pika 3, i Kushtetutës, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka gabuar duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, nëpërmjet të cilit është prishur vendimi i

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Kjo e fundit ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitën e ligjit penal favorizues. Gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë, ndaj tij duhej të zbatohej dispozita për lirimin me kusht që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, pasi në momentin që është dënuar me 25 vjet burgim nga Gjykata e Lartë, në përmbajtje të nenit 64 të KP-së nuk parashikohej kriteri ndalues për përfitimin e lirisë me kusht për personat e dënuar për veprat penale të parashikuara nga neni 79, shkronja “c”, i KP-së.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimimin e kërkesit

9. Çështja e legjitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Kolegji vlerëson se kërkuuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues, për rrjedhojë, si bartës i të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara, provon interesin e tij të drejtpërdrejtë në çështjen konkrete.

11. Një kriter tjetër paraprak ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Për plotësimin e këtij kriteri, kërkuuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i

mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural. Nga ana tjetër, duhet theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike *efektive*, në kuptimin e shterimit të atyre mjeteve që janë të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar vendimet e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor të iniciuar prej tij për lirimin me kusht. Në këtë situatë vlerësohet se ai nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimeve të kundërshtuara, për rrjedhojë ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

13. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 15.12.2022, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur, fillimisht, në Gjykatë në datën 11.04.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000 dhe pas plotësimit të tij, është regjistruar në datën 24.04.2023.

14. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar se vendimet gjyqësore objekt shqyrtimi, që kanë të bëjnë me fazën e ekzekutimit të një vendimi penal, cenojnë parimin e sigurisë juridike në aspekt të pritshmërive të ligjshme, parimin e detyrimit që kanë gjykatat kombëtare për të marrë në konsideratë KEDNJ-në dhe vendimet e GJEDNJ-së, si dhe parimin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, të garantuar nga neni 29, pika 3, i Kushtetutës. Nisur nga thelbi i pretendimeve të kërkuesit, Kolegji konstaton se ato nuk lidhen me një vendim të formës së prerë, prandaj bazuar në parimin *iura novit curia*, pretendimet e tij do të analizohen në këndvështrim të parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues në lidhje me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe kufizimin e lirisë personale, të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues.

*B. Për pretendimin e cenimit të parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe kufizimin e lirisë personale*

15. Kërkuesi ka pretenduar se me vendimmarrjen e tyre gjykatat kanë cenuar parimin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, sepse gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë ndaj tij duhej të zbatoheshin dispozita favorizuese dhe në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale për lirimin e tij me kusht, pasi në momentin që është dënuar me 25 vjet heqje lirie nga Gjykata e Lartë, neni 64 i KP-së nuk ka pasur të inkorporuar kriterin ndalues për përfitimin e lirisë me kusht prej personave të dënuar për veprat penale të parashikuara nga neni 79, shkronja “c” i KP-së. Vendimet objekt gjykimi kanë cenuar, gjithashtu, edhe kufizimin e lirisë personale, pasi ai është rikthyer në burg pas 4 vjetësh që gëzonte lirinë. Neni 64 i KP-së është ndryshuar në vitin 2013, pasi kërkuesi kishte kryer pjesën më të madhe të dënimit penal dhe kishte pritshmëri të ligjshme për përfitimin e lirisë me kusht.

16. Neni 29 i Kushtetutës parashikon se askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj, se nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale dhe se ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese. Ndërsa në jurisprudencën e Gjykatës e drejta e përfitimit nga efekti prapaveprues i ligjit penal favorizues, e sanksionuar në nenin 29, pika 3, të Kushtetutës, ka të bëjë me thelbin e një procesi të drejtë penal dhe, si e tillë, është e rëndësishme për respektimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 2, datë 15.02.2017; nr. 1, datë 20.01.2014; nr. 14, datë 17.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Për sa i përket standardit të arsyetimit të vendimit, Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Gjykata ka theksuar se vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje

koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimin nr. 41, datë 21.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Ndërkaq, liria personale është e garantuar nga neni 27, pika 1, i Kushtetutës, i cili parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj. Ajo mund të kufizohet vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht në pikën 2 të tij, ku, ndër të tjera, përfshihet dënimi i individit me burgim nga gjykata kompetente (*shkronja "a"*). Gjykata ka theksuar se qëllimi kryesor i kësaj dispozite është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustificuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike për një shoqëri demokratike. Në këtë drejtim është thelbësore që kushtet për heqjen e lirisë të jenë qartësisht të përcaktuara sipas ligjit të brendshëm dhe që vetë ligji të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij, për t'i mundësuar individit që të parashikojë, në një shkallë të arsyeshme, rrethanat dhe pasojat që mund të sjellë një veprim i caktuar (*shih vendimin nr. 39, datë 15.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në nenin 3, paragrafi 3, të KP-së parashikohet: *"Kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale"*, ndërsa në nenin 64, paragrafi 3, të KP-së, në fuqi në kohën e shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit për lirim me kusht, parashikohet: *"Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje, si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafin e tretë të nenit 100."*

20. Ligjvënësi ka ndryshuar disa herë përmbajtjen e nenit 64 të KP-së, nga momenti i dënimit të kërkuarit me vendim gjyqësor të formës së prerë në vitin 2001. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 144/2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", paragrafi i tretë i këtij neni është ndryshuar, duke shtuar një sërë kufizimesh për përfitimin e lirisë me kusht për disa vepra penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafin e tretë të nenit 100 të KP-së. Vepra penale e kryer nga kërkuari, që në momentin e gjykimit të tij parashikohej nga neni 79, shkronja "c", i KP-së, aktualisht parashikohet nga neni 79/b i KP-së.

21. Në rastin konkret, Kolegji vëren se në datën 19.09.2017 kërkuari i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë duke kërkuar lirimin e tij me kusht për pjesën e mbetur dhe të pavuajtur të dënimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka vendosur lirimin me kusht të kërkuarit

për dënimin e mbetur të pavuajtur prej 3 vjet, 3 muaj e 18 ditë, për një kohë prove me kohëzgjatje të njëjtë. Vendimi i kësaj gjykate është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit për lirim me kusht. Ky vendim është lënë në fuqi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Në vendimmarrjen e tyre, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë arsyetuar se në zbatim të ligjit material penal, konkretisht nenit 64, paragrafi 3, të KP-së që ishte në fuqi në momentin e depozitimit të kërkesës për lirim me kusht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, kërkuarisi nuk plotësonte kriteret ligjore për përfitimin e kësaj të drejte, pasi ishte dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 79, shkronja “c”, i KP-së, për të cilën, sipas nenit 64 të KP-së, ndalohet përfitimi dhe zbatimi i institutit të lirimimit me kusht.

22. Lidhur me parimin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, Kolegji konstaton se Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se në fazën e ekzekutimit të dënimit penal i dënuari ka të drejtë të bëjë kërkesa penale të caktuara të parashikuara në ligj, për të cilat ai mund të përfitojë nëse përmbush kriteret ligjore të parashikuara në ligj. Faza e ekzekutimit të dënimit është një fazë e shkëputur nga procesi penal, i cili zhvillohet në kuadër të përcaktimit të përgjegjësisë penale, pasi në momentin që vendimi për deklarimin fajtor të një subjekti merr formë të prerë, statusi i të pandehurit përfundon dhe subjekti objekt gjykimi në lidhje me autorësinë e veprës penale konsiderohet i dënuar dhe çdo kërkesë që ai bën më tej në lidhje me ekzekutimin e dënimit do të bëhet me statusin e të dënuarit. Në vijim të këtij arsyetimi, kjo gjykatë ka theksuar se në bazë të aplikimit të institutit të veprimit në kohë të ligjit penal, në fazën e ekzekutimit të vendimit penal zbatohet ligji i kohës që ka qenë në fuqi në momentin që i dënuari ka paraqitur në gjykatë kërkesën e veçantë penale me objekt lirim me kusht (*shih vendimin nr. 221, datë 17.05.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë, faqet 18 dhe 19*).

23. Edhe Gjykata e Lartë, duke u mbështetur edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, ka arsyetuar se lirimi me kusht është një mënyrë e ekzekutimit të dënimit me burgim, por nuk është dhe nuk mund të cilësohet si një lloj dënimi apo pjesë e tij. Lirimi me kusht nuk është element përbërës i dënimit të caktuar ndaj të kërkuarit, por është mënyrë e ekzekutimit të këtij dënimi. Ndryshimet ligjore që ka pësuar instituti i lirimimit me kusht në vitin 2013 nuk kanë cenuar dhe as kanë ndikuar në përkeqësimin e dënimit të caktuar ndaj kërkuarit. Neni 3 i KP-së është një normë që lidhet me identifikimin e normës penale më të favorshme në momentin e caktimit të dënimit përfundimtar për të akuzuarin/të pandehurin, që do të thotë se shtrirja kohore e zbatimit të kësaj norme vazhdon deri në momentin kur vendimi penal është përfundimtar (*shih vendimin nr. 00-*



2022-1617 (334), datë 15.12.2022 të Gjykatës së Lartë, faqja 10, paragrafi 19 dhe faqja 12, paragrafi 24).

24. Gjithashtu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka mbajtur në konsideratë edhe vendimin unifikues nr. 4, datë 27.03.2003 të Kolegjeve e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që në lidhje me zbatimin e nenin 3 të KP-së ka theksuar se fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues, në raport me momentin kohor të zbatimit të tij, nuk është e pakufizuar, pasi ky moment është i kushtëzuar nga faza në të cilën gjendet procedimi penal që i përket personit të akuzuar për kryerjen e veprës penale, fazë e cila nuk mund të jetë tej momentit kohor kur vendimi i dënimit penal të personit të akuzuar ka marrë formë të prerë (*shih vendimin nr. 00-2022-1617 (334), datë 15.12.2022 të Gjykatës së Lartë, faqja 12, paragrafi 25*).

25. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, faza e ekzekutimit të dënimit penal është konsideruar si fazë e veçantë nga ajo e dhënies së dënimit penal. Ajo është shprehur se në praktikën gjyqësore është bërë dallim midis një mase që përbën në thelb një “dënim” dhe një mase që ka të bëjë me “ekzekutimin” e dënimit. Si pasojë, kur natyra dhe qëllimi i një mase lidhen me faljen e një dënimi ose një ndryshim në regjimin për lirim të parakohshëm, kjo nuk është pjesë e “dënimit” sipas kuptimit të nenit 7 të KEDNJ-së (*shih vendimin e GJEDNJ-së Rio del Prada kundër Spanjës nr.42750/09, datë 10.07.2012, § 83*). Edhe në çështjen *Uttley kundër Mbretërisë së Bashkuar nr. 36946/03, datë 29.11.2005*, GJEDNJ-ja ka konstatuar se zbatimi ndaj kërkuesit të regjimit për lirim të parakohshëm nuk ishte pjesë e “dënimit” të vendosur ndaj tij.

26. Nisur nga sa më sipër, Kolegji vlerëson se faza e ekzekutimit të vendimit penal është një fazë e veçantë nga ajo e gjykimit në themel për dhënien e vendimit të dënimit. Në këtë drejtim, lirimi me kusht i parashikuar në nenin 64 të KP-së është një nga alternativat që mund të caktohet nga gjykatat gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal kur i dënuari ka vuajtur pjesën thelbësore të dënimit me burgim dhe vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin e tij. Prandaj, neni 64 i KP-së që ka qenë në fuqi në momentin e dënimit të kërkuesit (vitin 2001), nuk mund të gjejë zbatim në momentin e aplikimit të kërkuesit për lirim me kusht (në vitin 2017). Në këto rrethana, Kolegji çmon se gjen zbatim dispozita e ligjit penal që është në fuqi në momentin e paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht nga i dënuari, pasi plotësimi i kërkesave të ligjit do të verifikohet në këtë moment. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues është haptazi i pabazuar.

27. Për sa i përket pretendimit të cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, Kolegji vlerëson se në përputhje me standardet e evidentuara në jurisprudencën kushtetuese, vendimet objekt gjykimi paraqiten të rregullt në formë dhe nuk rezultojnë paqartësi ose kundërthënie në përmbajtjen e tyre. Në pjesën hyrëse të vendimit të Gjykatës së Lartë janë paraqitur rregullisht faktet e çështjes, pretendimet e kërkuesit në rekurs, vendimmarrjet e gjykatave më të ulëta, ndërsa në pjesën arsyetuese, sikurse u theksua edhe më lart, është parashtruar ligji i zbatueshëm, është marrë në vlerësim vendimmarrja e gjykatave, si dhe u është dhënë përgjigje shteruese pretendimeve të ngritura në rekurs.

28. Po kështu, Kolegji vëren se në bazë të informacionit të administruar për efekt të këtij ankimi kushtetues, me anë të shkresës nr. 227/1, datë 01.06.2023 të Degës Territoriale Krujë të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës, rezulton se në këtë degë apo edhe në degë të tjera të shërbimit të provës nuk është marrë për zbatim asnjë urdhër ekzekutimi i ndonjë vendimi për lirim me kusht të kërkuesit. Sipas informacionit të marrë edhe më parë nga ky institucion në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë, për kërkuesin nuk është nxjerrë për zbatim ndonjë urdhër i tillë ekzekutimi. Edhe në bazë të shkresës nr. 3923 prot., datë 27.06.2023 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë rezulton se për kërkuesin nuk është marrë vendim për pushimin e ekzekutimit të dënimit penal, pasi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë është ankimuar nga prokurori i çështjes dhe nuk rezulton që ai të jetë vënë në ekzekutim për pjesën që i takon shërbimit të provës.

29. Në këtë këndvështrim, Kolegji çmon se për sa kohë që gjykatat nuk janë shprehur me vendim të formës së prerë për përfitimin e dënimit alternativ të lirimit me kusht dhe organi i prokurorisë në asnjë rast nuk ka nxjerrë urdhër për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, kërkuesi nuk ka qenë asnjëherë në shërbim prove për lirim me kusht, por ndaj tij ka qenë gjithmonë në fuqi dënimi penal me burgim.

30. Në analizë të sa më sipër, Kolegji vlerëson se edhe pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe kufizimin e lirisë personale janë haptazi të pabazuara.

31. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

---

Vendim i Kolegjit  
Kërkues: Genc Tafilaj

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.